

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË VITIT 2011

Tabelë 1: Vëllimi i operacioneve të përkohshme të tregut të hapur (në milionë lekë*).

DATA	R/REPO njëjavore me çmim variabël	R/REPO ditore	R/REPO tremujore
07.07.2011	19,640.00		
14.07.2011	19,560.00		
21.07.2011	20,400.00		
28.07.2011	21,800.00		
04.08.2011	21,300.00		2,000.00
11.08.2011	25,000.00		
18.08.2011	20,500.00		
25.08.2011	22,300.00		
01.09.2011	22,700.00		3,000.00
08.09.2011	19,500.00		
15.09.2011	19,100.00		
22.09.2011	24,000.00	1,500.00	
23.09.2011		1,480.00	
29.09.2011	20,500.00		

1.1. Operacionet e tregut të hapur

Ndërhyrjet në tregun e parasë, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2011, përfshijnë operacione të tregut të hapur për injektim të likuiditetit.

Për injektimin e likuiditetit Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor, mesatarisht 21.25 miliardë lekë në javë* si dhe marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim tremujor, e cila u përdor në 2 raste, mesatarisht 2.5 miliardë lekë për ankaand. Në datat 22 dhe 23 shtator 2011, të cilat përkonin dhe me dy ditët e fundit të periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar, u përdor instrumenti, marrëveshje e anasjelltë riblerjeje me maturim njëditor, në shumën 1.50 miliardë lekë në secilin rast*.

1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse


Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2011, depozita njëditore u përdor në 10 raste, mesatarisht 0.18 miliardë lekë, gati 0.02 miliardë lekë më pak se tremujorin e kaluar, kur ky instrument është përdorur në 19 raste, mesatarisht për 0.20 miliardë lekë. Përdorimi i depozitës njëditore është përqendruar kryesisht në datat 22 korrik, 23 gusht e 23 shtator që përkojnë me fundin e periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar.

Instrumenti i kredisë njëditore është përdorur në 9 raste, mesatarisht 0.05 miliardë lekë, kundrejt 13 rasteve të tremujorit të kaluar me një mesatare 0.23 miliardë lekë.

* Shifrat janë të shprehura në vlerë nominale.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmblëdhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë për vitin 2011.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë vitit 2011 (me çmim blerjeje).



2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË VITIT 2011

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2011, Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në tregun valutor në krahun e blerjes së valutës nga bankat e nivelit të dytë me objektiv rritjen e rezervës valutore neto. Si rezultat i ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë, gjatë kësaj periudhe u shitën 125.24 milionë lekë.

2.2 Veprime me institucione të tjera

Gjatë kësaj periudhe kanë vijuar të realizohen veprime të shitjes dhe të blerjes së valutës me Ministrinë e Financave. Veprimet e këtij tremujori kanë qenë sërish të lidhura kryesisht me kontratat *swap*, ndërkohë që pagesat e borxhit të jashtëm janë kryer me fondet e Ministrisë së Financave. Blerjet nga Ministria e Financave gjatë kësaj periudhe qenë 4,117.39 milionë lekë, ndërsa shitjet 3,507.66 milionë lekë. Ndërkohë, nëse do të përjashtonim marrëveshjet *swap*, veprimet totale janë blerje valute në kundrvlerën e 625.20 milionë lekëve.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 70.11 milionë lekë (Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim – IDA dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - IBRD).

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të tretë të vitit 2011

Institucioni financiar	Blerje të valutës (në milionë lekë)	Shitje të valutës (në milionë lekë)
MINISTRIA E FINANCAVE <i>SWAP</i>	3,492.19	3,507.66
MINISTRIA E FINANCAVE <i>OUTRIGHT</i>	625.20	
TË TJERA (IDA, IBRD)	70.11	